



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 16 dhjetor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Zgjatje Afati**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 9(5)(a), (6) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 14 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit ("z. Thaçi") ("Vendimi mbi Paraburgimin").<sup>2</sup> Në Vendimin mbi Paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi z. Thaçi të dorëzonte, nëse dëshironte, parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit jo më vonë se dita e hënë, 17 janar 2022.<sup>3</sup>

2. Më 15 dhjetor 2021, gjatë konferencës së nëntë për ecurinë e çështjes dhe me kërkesën e Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ua zgjati afatin Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit për dorëzimin e parashtrimeve të tyre në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri jo më vonë se 10 ditë pas njoftimit të vendimeve përkatëse të Gjykatës së Apelit mbi apelet kundër vendimeve mbi mbajtjen në paraburgim.<sup>4</sup>

3. Gjatë së njëjtës konferencë për ecurinë e çështjes, z. Thaçi i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake t'i lejonte një zgjatje të ngjashme afati, gjegjësisht t'i autorizonte dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit jo

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00624, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 14 dhjetor 2021 (njoftuar më 15 dhjetor 2021), konfidencial.

<sup>3</sup> Vendimi mbi Paraburgimin, para. 103(b).

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript, 15 dhjetor 2021 ("Transkript i 15 dhjetorit 2021"), publik, f. 763, rreshtat 8-25, f. 764, rreshtat 1-3.

vonë se 10 ditë pas njoftimit të vendimit të Gjykatës së Apelit mbi apelin e ardhshëm kundër Vendimit mbi Paraburgimin ("Kërkesa").<sup>5</sup>

4. Më 16 dhjetor 2021, z. Thaçi kërkoi zgjatje të afatit për dorëzimin e apelit të tij kundër Vendimit mbi Paraburgimin,<sup>6</sup> ku bënte të ditur synimin për ta apeluar vendimin në fjalë.<sup>7</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej Panelit.

6. Në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, në qoftë se nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare, vendimi mbi një kërkesë për ndryshimin e afatit mund të merret pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

7. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores parashikojnë se, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

## III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se parashtrimet e z. Thaçi në lidhje me paraburgimin do të përfitonin nga një analizë e vendimit të pritshëm të

---

<sup>5</sup> Transkript i 15 dhjetorit 2021, f. 764, rreshtat 7-11.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, IA017/F00001, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatje të Afatit të Parashtrimet të Apelit kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit* ("Kërkesa për Zgjatje Afati të Apelit të Vendimit mbi Paraburgimin"), 16 dhjetor 2021, publik.

<sup>7</sup> Kërkesa për Zgjatje Afati të Apelit të Vendimit mbi Paraburgimin, para. 2.

Gjykatës së Apelit dhe, rrjedhimisht, konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se, duke kërkuar miratimin e të njëjtës zgjatje afati që u është miratuar të akuzuarve të tjerë, z. Thaçi ka hequr dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit të tij para përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.

#### IV. VENDIMI

9. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën;
- b. **URDHËRON** z. Thaçi të paraqesë parashtrime nëse ekzistojnë ende arsye për mbajtjen në paraburgim jo më vonë se **dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të Gjykatës së Apelit** në lidhje me apelin e tij të ardhshëm kundër Vendimit mbi Paraburgimin, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- c. **URDHËRON** Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), nëse z. Thaçi vendos të mos dorëzojë asnjë parashtrim brenda afatit të lartpërmendur, të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se **dhjetë ditë pas afatit të z. Thaçi**, dhe z. Thaçi, nëse dëshiron, të dorëzojë parashtrimet e veta jo më vonë se **dhjetë ditë pas afatit të ZPS-së**.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E enjte, 16 dhjetor 2021  
Hagë, Holandë.